

VENDIM
Nr.360, datë 26.9.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA RADIO NË SHQIPËRISË “WORLD FAMILY”
SUBJEKTIT:SHOQËRIA “SCORPION” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të rregullores “Për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës”, miratuar me vendimin nr.26, datë 23.10.2000 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

- 1.T’i japë shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programit të huaj radio me përsëritës World Family, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë, Shkodër dhe Elbasan.
2. Afati i licencës është 3 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj.
3. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj